



Republika e Kosovës – Republic of Kosovo
Komuna Hani i Elezit- Municipality of Elez Han



02Nr 8298 /2022
30.09.2022

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, Kapitulli V neni 67 dhe 68 , Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 neni 5 pika c, Ligjit të Punës Nr.03/L-212 neni 8 Udhëzimin Administrativ(MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik,Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.05/2021, Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm si dhe UA.01/2022 Për ndryshimin dhe Plotësimin e udhëzimit administrativ(MASHT) nr.05/2021 Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm,
Komuna Hani i Elezit shpallë:

K O N K U R S

(Për plotësimin e vendit të lirë të punës)

Institucioni: **Komuna Hani Elezit**

Drejtoria: **Drejtoria për Arsim,Kulturë,Rini dhe Sport**

**1.Titulli I vendit të punës: Edukatore kopshti i fëmijëve 3-6 vjeç
njësia/ sektori: IP "Ardhmëria"**

Numri I pozitave: **Një (1) pozitë me afat të pacaktuar;**

Koeficienti/Grada: **A- 393/1**

Orët e punës: **40 orë në javë**

Kushtet e pjesmarrjes në rekrutim:

- Fakulteti i Edukimit – programi katërvjeçar i nivelit baçelor për edukimin parashkollor;
- Shkolla e Lartë Pedagogjike – drejtimi për edukatorë;
- Fakulteti Filozofik – dega e pedagogjisë së përgjithshme;
- Përkujdesje dhe mirëqenie e fëmijëve;

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- I realizon qëllimet dhe detyrat e arsimit dhe edukimit;
- Planifikon dhe realizon planin vjetor, mujor të punës arsimor dhe edukativ,
- Përdor metoda dhe teknika bashkohore të mësimdhënies duke marrë parasyshë
- Nevojat individuale të nxënësve;
- Harton plane idividuale për nxënësit;
- Të edukojë fëmijën si një qenie të shoqërueshme të aftë, që të krijoj mardhënie me të tjerët;
- Mësimin e rregullave dhe bashkëpunimin në grup;
- Duhet të jenë të motivuara që të punojnë me fëmijë;
- Kryen punë tjera që I cakton drejtori i institucionit;

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit (merret në Komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë)
- Rezymeja personale (CV).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë kopje).
- Diploma e kualifikimit (ose certifikata) duhet të jete kopje të noterizuar.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime (nga gjykata)
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 30.10.2022 deri 13.11.2022 (16:00).

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit mund ti marrin në formë fizike pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati I parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend, apo ti shkarkojnë në portalin shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net> Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret e konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në faza tjera do të ftohen vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e që futen në listë të ngushtë.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet, jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Mirë priten aplikacionet e femrave dhe meshkujve të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>, në web faqen e komunës <https://kk.rks-gov.net/hanielezit> dhe në tabelën e shpalljes.

Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi

